

Martin Camaj, një sekret që
nuk mund të përshkruhet me tri fjalë
Bisedë me Znj. Erika Camaj

**Martin Camaj, a secret that cannot be described in few words
Interview with Mrs Erika Camaj**

Abstract: For the first time our journal publishes an exclusive interview with Mrs Erika Camaj, wife of the renowned writer Martin Camaj, who lived between Shkodra, Belgrade, Rome and Munich, where he passed away. Mrs Erika Camaj in this interview throws more light on many unknown or little known aspects of the life and works of the late Albanian writer thus contributing to understanding more in depth his human and artistic journey.

Atje, rrëzë Alpeve të Bavarisë, në Lenggries, 50 km larg Munihut, në kufi me Austrinë, njohëm nga afër këtë grua, që, drejt të 90-tave të saj po jeton edhe tani me Martinin, për Martinin.

Në verandë e gjetëm duke lexuar një libër studimor për Camajin me fjalorin e shqipes pranë.

Një mirëseardhje e ngrohtë dhe e fisme. I kemi sjellë lule. “Të bukura!-tha-ju Faleminderit! Po ia shpiem Martinin.”

Lulet e bardha e ato të portokallta i hoqëm nga vazot e tyre e i mbollëm me ndihmën e një lopate të vogël aty ku prehet Martini, duke i bërë një nderim të thellë atij. Guri i varrit është granit, i sjellë nga vendlindja. Varrezat janë të paqta pranë kishës. Natyra është përrallore. Fshati, jashtëzakonisht i bukur.

E panginjur për të ditur se çfarë thuhet tashmë për Martinin, cilat janë interesimet më të fundit për veprën e tij, ajo na drejtohet me një shqetësim të bukur, të përmbajtur. I tregojmë zj. Camaj se poezia dhe proza e tij kanë zënë vendin e duhur në programet dhe tekstet shkollore të të gjithë sistemit tonë, si dhe në studimet universitare dhe akademike në mbarë hapësirën kulturore shqiptare.

E di këtë por gati nuk e beson ose i duket se gjërat do të ndryshojnë prapë. Asaj i duket se “të tijtë” vazhdojnë t’i rrinë larg e mos ta afrojnë, sikur të kishin mëri a pandjeshmëri të përjetshme ndaj tij. Si për t’u siguruar, pyet sërish.

Pylli i pafund që ngjitet malit përpjetë shpërndahet gjithandej sa të ha syri në tokë e në qiell.

-Iku shpejt... -thotë në gjuhën shqipe me pikëllim dhe përhumbet për pak. Duket se përmban emocione të mëdha; në bisedën tonë me të, tregohet e matur.

Megjithatë, na tregoi kaq gjëra... Ajo na tha se Italia ishte për Martinin atdheu i dytë.

Ajo na zbulon se "Qyteti milionësh", një nga qendrat gravitacionale kronotopike në poetikën e Martin Camajt qenka New York-u dhe, përtej kësaj, na tregon hollësi të jetës familjare, shoqërore dhe kulturore, si dhe dukuri që e lanë të çuditur.

Zonja Erika Camaj na rrëfen marrëdhënien me Beogradin, me shqiptarët e Kosovës, financimet, rrugëtimin e tij derisa ndërroi jetë në krahët e saj.

Kur e pyesim sesi esencialisht si do ta definojnë Njeriun Camaj,- "Si po më thoni? Ta përshkruaj Camajn me tri fjalë? Të përshkruaj një personalitet me tri fjalë është sigurisht, shumë e vështirë. Njeriu është në vetvete shumë i ndërlikuar dhe përbën një sekret që nuk mund të përshkruhet me tri fjalë".

Na tregon se Festa verore në shtëpinë e saj organizohet për nder të studentëve të Albanologjisë. Gjithmonë në fund të vitit, Camaj i mbledhte studentët e vet këtu në shtëpi, si një lloj shpërblimi për punën e tyre gjatë gjithë vitit. Ajo na thotë në fund se kjo festë do të organizohet për studentët e Albanologjisë derisa të ketë frymë.

1. Zonja Camaj, ishte e thënë që ju të takonit njeriun Martin Camaj, çka do të shënonte përgjithmonë jetën tuaj. Si ndodhi ky takim?

Erika Camaj: Kam njohur Martin Camajn në rrethin tim të njohurve në universitet. Një shoqe imja studioje Sllavistikë te Profesor Schmaus, dhe Martin Camaj erdhi nga Italia në Gjermani përmes Profesor Schmaus-it, që ishte vlerësuesi i tij. Unë isha miqësuar dhe me gruan e Profesor Schmaus-it, dhe më vonë isha dhe mjekja e familjes së çiftit.

Ishte një takim universitar që më kujtohet shumë mirë, sepse nuk doja të shkoja. Sapo isha kthyer nga Amerika mirëpo duhet të shkoja te ky takim. Vendosa më në fund të shkoja pa e ditur që ky takim do të ishte kaq i rëndësishëm për gjithë jetën time.

2. Zëri më kumbues i poezisë shqipe përgjatë gjysmës së dytë të shek. XX, personaliteti më tërheqës i këtyre letrave, ndër më inteligjentët dhe eruditët në historiografinë letrare të një kombi-mund të mendojmë se ai kishte çdo cilësi që thërriste për një dashurim të thellë. A ishte vërtet kështu dhe në takimin tuaj? A ishte ai simpatik, tërheqës për ju?

Erika Camaj: Atëherë, së pari duhet thënë që një malsor nuk është sharmant, prandaj më duhet t'i bie ndesh cilësimit. Një malësor është

malësor. Por natyrisht, Camaj kishte një lloj personaliteti që i fitonte menjëherë njerëzit përreth tij. Këtë mund ta them edhe nga ana personale, përndryshe ndoshta nuk do të isha martuar me të.

Ai ishte shumë njerëzor dhe shumë i përkushtuar ndaj studentëve. Studentët e tij vijnë dhe sot e kësaj dite më vizitojnë. Kjo, nga njëra anë më gëzon, dhe nga ana tjetër, tregon që ata e kanë nderuar gjithmonë Camajn.

3. Si shkoi marrëdhënia me Martinin deri në kurorëzimin tuaj?

Erika Camaj: Marrëdhënia ime me Martinin, në fillim ishte shumë e ngatërruar. Unë kisha një lidhje, të cilës i dhashë fund menjëherë, kurse Martini u divorcua. Nga ana tjetër, më duhej të përballesh me familjen. Unë vij nga një familje kaq katolike dhe nuk mund as të imagjinohej që unë të martohesha me një burrë të ndarë! Babai im donte të bëhej prift, mirëpo, ra në dashuri me nënën time. Megjithatë, unë ia prezantova Martinin familjes sime menjëherë, dhe nëna ime u ndie veçanërisht shumë e ngazëllyer nga Martini.

Edhe më vonë, kur u martuam, nëna ime i plotësonte Martinit shumë dëshira, sidomos, nëse ai dëshironte ndonjë gjë speciale për të ngrënë, që unë nuk ia gatujta. Menjëherë e gatuate nëna ime. Kështu, Martini u bë personi më i dashur i mamasë time.

Për babain ishte e papëlqyeshme që e vetmja vajzë e tij me titull akademik të merrte një burrë të ndarë.

E megjithatë, ne u martuam.

4. Ju ka lënë të habitur ndonjë gjë që lidhet kryesisht me traditën nga ai vinte?

Erika Camaj: Përpara se të martohesha, po ju tregoj se më ndodhi një gjë e çuditshme dhe njëkohësisht e bukur. Vonë e kuptova që në traditën e vendit nga vinte Martini, përpara se burri të martohet, nusen e tij duhet ta vlerësonte gjithë fisi. Në rastin tim kjo nuk mund të realizohej sepse Martini nuk mund të kishte kontakt me familjarët e tij. Zgjidhja ishte bizantinisti Giuseppe Schirò-i, që erdhi nga Sicilia në Gjermani për të më çmuar mua. Ai nuk dinte asnjë fjalë gjermanisht, dhe unë nuk dija asnjë fjalë në italisht, por shpëtimi ynë ishte latinishtja.

Folëm latinisht. Përfundimi i Schirò-it pas bisedës ishte: *martohu me këtë grua sa më parë!*

5. Dhe kaluat një jetë së bashku dhe ja ku jemi tani te shtëpia Camaj! Shtëpia juaj dykatëshe dhe me papafingo është mes një kopshti me gjelbërim, drurë dhe lule ngjyra- ngjyra, me një fontanë të vogël, një skulpturë lope, po ashtu. Nga dhoma e madhe e ndenjes dolëm

në këtë verandë të shtruar me gur, këtu kemi edhe oxhakun që ndizte Martin Camaj për t'i ndërmendur fëmijërinë në fshatin e tij, në Temal. Ndërtimi i kësaj shtëpie, si u krye?

Erika Camaj: Ndërtimi i shtëpisë u krye përmes një agjencie. Si fillim duhej të përzgjidhnim tokën, dhe të kishim një shumë të konsiderueshme të hollash që ne nuk i kishim në fakt. Ne blemë një tokë të shtrenjtë lart në alpet e Lenggries. Sigurisht që morëm kredi, sepse rrogat tona ishin shumë të larta. Unë isha mjeke dhe Martini profesor. Sigurisht që ishim në gjendje të paguanim kredinë, dhe njëkohësisht të bënim një jetë të qetë dhe të mirë, me shumë udhëtime e takime.

6. E këto dyer druri ngjyrëçelët, me harqe lart, këto doreza si me valëzim?

Erika Camaj: Ato janë sipas stilit arbëresh...

7. Camaj studiues-gjuhëtar, filolog, etnolog. Nga Shqipëria, në Beograd, nga Beogradi në Romë. Në fund të dhjetorit 1960, ai mbërriti në me një bursë dhjetë mujore prej DAAD-së. Do të na tregoni, zonja Camaj, si arriti ai te dega e pazakontë e albanologjisë dhe drejtimi i saj në universitetin më prestigjioz në Gjermani?

Erika Camaj: Katedra e Albanologjisë në Ludwig Maximilians Universitët nuk e ka filluar menjëherë aktivitetin e saj si një profesurë, por si lektorat. Profesor Schmaus-i e mbështeti shumë krijimin e lektoratit. Më vonë u përfshinë edhe shumë profesorë të tjerë në mbështetje të shqipes. Këta profesorë nuk e ndihmuan Martinin vetëm profesionalisht, por edhe personalisht. Themelimi i një katedre është një gjë shumë e vështirë, sepse kushton para, dhe, çfarë kushton para arrihet gjithmonë me vështirësi.

8. A e shqetësonte Martinin natyra e këtushme, e ndryshme nga ajo mesdhetare? Çfarë i mungonte më shumë? Çfarë gjeti të ngjashme?

Erika Camaj: Një pyetje shumë interesante. Ja, së pari, një malësori nuk i mungon deti, sepse është malësor. Përsa u përket maleve, i kishte këtu në Lenggries. Ai ishte madje shumë aktiv në ngjitjet në mal. Edhe kur nuk njihej ende me mua, ai kishte një mik shqiptar që quhej Hilë Topalli me të cilin ngjisnin bashkë malet.

9. Por te vargjet e *Bletës në veri*, Pipa gjen një përvojë personale, largimin e Camajt nga Roma për në Munih, emri gjerman i të cilit, München, i kujton mbiemrin “i mungët”, që rrjedh nga mung (ar) apo murg – gjerm. “Net të mungëta”, duket se janë net të kaluara në

Munih, duke përgatitur disertacionin gjermanisht,- të ngjashme me netët e kaluara në manastire nga murgjit që kopjojnë libra të rrallë. Poezia përçon vendosmërinë e poetit për të mos e braktisur poezinë, madje edhe në një qytet “veri(or)”, si Munihu, klima kulturore e të cilit, siç vijon Pipa, nuk është e përshtatshme për një mesdhetar.

Ky koment na kujton se autori iku nga Roma pa dëshirë.

Erika Camaj: Duhet thënë që Martin Camaj nuk erdhi në Gjermani që të qëndronte këtu; arsyeja se pse ai qëndroi, isha unë.

10. Vepra letrare e Martin Camajt u përket hapësirave të ndryshme: bjeshka, verrini, ujërat e Drinit, Shkodra, (Asht një qytet që mbiu herët/në gjijet e shkambit; Palermo 1968) dhe përsëri e kudo: hapësira alpine si mjedis konkret dhe i figurshëm- shenjë pastërtie e papërsëritshme.

Po nga ana tjetër, ja ku është Qyteti, Metropoli, Megalopoli, Qyteti “milionësh” - nga topikat më domethënëse të poezisë së Camajt, pothuaj me po atë forcë gravitacionale sa dhe Alpet por me strukturë e mjedis trazues. *Qyteti milionësh* mund të jetë çdo qytet perëndimor, pikënisja, megjithatë, nuk më ngjan të jetë qyteti i Munihut. Ai vjen si vend i përqendrimit të masave të mëdha të njerëzve, sepse është superqendra e ndryshimeve dhe e zhvillimit, kësisoj dhe e ngadhënjimit ndaj së keqes por, m’anë tjetër edhe e gjumit dhe e mjegullës. Mes një lloj letargjieje, ai bëhet vend i verbërisë dhe shurdhërisë sa i takon ndjeshmërisë ndaj rreziqeve në prag që e kërcënojnë. Është një vatër tërheqëse e madhe, megjithatë.

Erika Camaj: Martini kishte plane të tjera. Ai ishte në kontakt me shqiptarët e Amerikës, dhe qëllimi i tij ishte ngritja e një profesure për Albanologji në New York. Për këtë arsye, ai shkonte shpesh në Amerikë. Edhe unë shkova në Amerikë për një shkëmbim akademik pas studimeve të mia për mjekësi, dhe isha unë, në fakt, që nuk e doja Amerikën, për arsye kryesisht kulturologjike.

Në të vërtetë, në bisedat tona të para ai u interesua shumë pikërisht nga fakti që unë kisha qenë në Amerikë dhe ai kishte për qëllim të shkonte atje.

Unë nuk ia këshillova Amerikën, madje i thashë të ketë kujdes sepse atje nuk do të gjejë atë mjedisin e kultivuar të cilin ai e pret.

I thashë edhe që, nëse ndodh hapja e një profesure për Albanologji në New York, do të jenë një grup njerëzish të pasur që do ta financojnë, dhe Martini duhet ta kalonte të gjithë karrierën e tij duke nderuar këta njerëz. Kjo nuk më dukej zgjidhje. E kam këshilluar me një qëndrim shumë neutral

për këtë gjë, dhe edhe sot e kësaj dite kur e sjell ndër mend këtë, mendoj se i kam dhënë Martinit një këshillë shumë të mirë.

11. Vazhduat të ndikonit edhe më tej?

Erika Camaj: Pasi u martua me mua Martini mori dhe pasaportën gjermane. Në fakt, kjo ishte dhe një ndihmë e madhe për profesurën e Albanologjisë. Në atë kohë nuk mund të përfytyrohej punësimi i shtetasve të huaj.

12. Qëndrojmë edhe pak tek qytetet. Koha, në fazën e dytë dhe të tretë të krijimtarisë së tij, duke u bërë e dendur dhe kompakte, bëhet edhe edhe më enigmatike artistikisht; hapësira intensifikohet dhe hyn në lëvizjen e kohës, të komplotit, të historisë. Dimensioni, dendësia dhe heterogjeniteti bashkohen me figurën e qytetit të stërmadh. Atëherë dhe përfundimisht *qyteti milionësh*, kjo topikë me peshë në poezinë e tij, e ka pikënisjen te New York-u?

Erika Camaj: Ne do të shkonim edhe paskësaj, shpesh në New York. Kështu, qyteti milionësh, po, ishte New York-u.

13. Ky është një zbulim që na kënaq. Po Beogradi çfarë ishte për të?

Erika Camaj: Beogradi ishte për Martinin, në radhë të parë, vendi ku ai njohu gruan e tij të parë dhe u martua. Por atje ai ishte gjithsesi mes serbëve dhe nuk bënte jetën më të mirë të mundshme. Në Beograd kishte një komunitet shqiptarësh me të cilët ai shoqërohej. Megjithatë, ai shkoi pastaj në Itali, për arsye politike. Ai u përfshi disi politikisht në Beograd dhe kjo nuk i pëlqeu regjimit të asokohshëm.

14. Dhe cili ishte shtegu i “shpëtimit”?

Erika Camaj: Italia ishte shpëtimi i tij, një stacion i rëndësishëm për të edhe për arsye gjuhësore. Ai studioi te jezuitët dhe e njihje italishten.

15. Pra, jemi në Romë, prej ku erdhi nga Beogradi dhe ku fitoi një diplomë italiane në Departamentin e Letërsisë dhe Filozofisë. Teza e tij, *Meshari i Gjon Buzukut*, një studim për gjuhën e librit më të vjetër shqip, e orientoi drejt një karriere linguistike. Ernest Koliqi, profesori i tij i shqipes në Universitetin e Romës, sapo kishte filluar botimin e revistës letrare, *Shêjzat (Le pleiadi)*. Camaj u bë redaktor i kësaj reviste, ku botoi poezi dhe artikuj. Në *Shêjzat* u botua si vëllim më vete vepra e tretë poetike e Camajt, *Djella*, një

prozë e ndërthurur me poezi.

Po ju, çfarë ju lidh me botën arbëreshe? Cilat kujtime? Cilët njerëz janë sidomos domethënës lidhur me historinë që po jetonit me Martinin?

Erika Camaj: Martini vazhdoi të shkonte gjithmonë tek arbëreshët për kërkim në terren. Përpara martesës, ai donte të më merrte mua në Itali. Kishte shumë miq priftërinj mes arbëreshëve, madje mund të them që miqtë e tij më të mirë ishin priftërinj. Unë i thashë Martinin që nëse unë të shoqëroj atje si e dashura jote dhe jo si bashkëshortja jote, kjo mund të fyejë priftërinjtë, kështu që më mirë po rri këtu dhe nuk po vij. Atij nuk i pëlqeu kjo gjë sepse ai dëshironte të më prezantonte para miqve të tij. Pastaj ne e përsheptuam martesën. Zyrtari që na martoi donte shumë të na gëzonte dhe për këtë, vendosi për ne orkestrën Hochmarsch të Mendelssohn-Bartholdy.

Martini pëlqente që martesë të bëhej në rrethin tonë të ngushtë, pra vetëm familja. Aty morën pjesë dy motrat e mia, që ishin ndërkohë të martuara. Unë isha motra e fundit që martohej. E kësisoj, organizuam një festë të vogël. Kjo ishte e mrekullueshme. Babai im kishte rezervuar një restorant në të famshmen Fernsehturm të Munihut, ku dhe drekuam.

Midis miqve arbëreshë të Martinin, ishte Pater Valentini, shpëtimi im.

Ishte ai që më ndihmoi të kaloja trazimin tim, sepse gjithë kohës isha e shqetësuar nëse miqtë e Martinin do të më pranonin si një grua që martohet me një burrë të ndarë. Pater Valentini më mbante pranë vetes gjatë gjithë qëndrimit tonë në Itali. Në çdo vakt ushqimor, unë kisha gjithmonë vendin tim në tryezë krahas Pater Valentinit. Ky ishte një sinjal për priftërinjtë e tjerë, që çdo gjë ishte në rregull.

E kam çmuar shumë Pater Valentinin dhe kisha kontakt me të vazhdimisht.

16. Camaj kaloi jetën në kërkimin e fjalës së humbur, të fatit tragjik dhe mënyrave si të mbetemi gjallë. Edhe kur studion edhe kur gdhend vargun nga shpërthejnë struktura e trajta të përsosura, bota arbëreshe është aty. Sa herë shkoi paskësaj te arbëreshët dhe çfarë mbeti Italia për të?

Erika Camaj: Udhëtimin në Itali e kemi bërë çdo vit. Çdo vit kalonim kohë te arbëreshët. Italia ishte për Martinin atdheu i dytë. Kjo reflektohet edhe në letërsinë e tij.

17. Duke folur për topikat, duhet të themi se dallojmë, përpos malit e qytetit, edhe një vend të midistë (“në mjedis malit e qytetit”) si te Kukullat në pushim apo Vend i thyeshëm ku hapet humbera deri në

lumë, e krijime të tjera poetike.

Poe edhe vetë qyteti, sipas një traditë të rrënjësor thellë, shihet nga dy këndshikime të kundërta: njëri se “Njerëzit mblidhen në qytet e mbeten atje për të jetuar një jetë të mirë.” dhe ai i një vendi armiqësor dhe kërcënues për individin.

Është një tension i përhershëm, i tillë që nuk mbaron kurrë, ky, në veprën camajane.

Disa herë, qyteti i merr dhe konotacionet e kohës të manifestuara në hapësirë, diakroni dhe sinkroni, siç është poezia *Aty si para se me ardh fiset*. Por, vendi i Camajt del gjithmonë mes dy forcave njëloj tërheqëse, si të *Legjenda e Shotës-gruas* së ujërave që jetonte mëdyshas, midis vendlindjes dhe mjedisit të ri, mes bimëve ujce dhe terës, mes dashurisë për Drinin dhe Njeriun e tokës. Si e gjente Martini drejtpeshimin (jo vetëm midis mjedisëve të ndryshme, po edhe aspekteve të ndryshme të jetës së tij)?

Erika Camaj: Martini ishte një person me qetësi të brendshme, harmonik dhe optimist. Përsa i përket stilit të tij të punës, ai e kishte paksa më të ndryshëm se shqiptarët. Martini punonte shumë, sidomos me punimin e habilitacionit.

Ai thoshte gjithmonë që ideale për të do të ishte të jetonte në Itali por të punonte në Gjermani. Gjithmonë kujdesej që të balanconte kërkimin shkencor, mësimdhënien dhe jetën private me mua.

Nuk ishte vetëm puna si profesor ajo që na ngarkonte, por ne kishim gjithmonë shumë të ftuar në shtëpi. Shqiptarë nga Shqipëria ende jo, por shqiptarë të Kosovës, kishim shumë.

Njerëz që e dinin që Martin Camaj jetonte në Lenggies. Çdo javë na vizitonte ndonjë shqiptar që kishte vështirësi. Shumë prej tyre kishin probleme ligjore, por jo për shkak të tyre, aq sa për shkak të paditurisë se si funksionojnë gjërat në Gjermani.

17. A mund ta sqaroni edhe pak këtë?

Erika Camaj: Kishte shumë shqiptarë të Kosovës që gjendeshin përpara gjyqit. Shpeshherë për vogëlsira, por edhe për gjëra serioze. Martini ka përkthyer shpeshherë në gjyq për kësi rastesh, por dhe i ka ndihmuar shumë njerëzit. Disa prej tyre ai mundi t’i nxjerrë nga burgju.

18. Camaj është përmendur lidhur me Franz Josef Strauss...

Erika Camaj: Franz Josef Strauss-i donte të udhëtonte në Shqipëri, dhe kërkohet ekspertiza e Martin Camajt. Kështu u ftuam në një darkë festive nga zoti Strauss, aty Martini i dhuroi veprën e tij *Albanian Grammar*. Dhe pastaj Strauss-i i dërgoi një letër Camajt ku e falënderonte për dhurimin e

Albanian Grammar dhe i tregonte se po udhëtonte për në Shqipëri dhe e kishte librin me vete në valixhe.

19. Po Arshi Pipa?

Erika Camaj: Ishte një miqësi intelektuale me Arshi Pipën. Ata mendonin tërësisht ndryshe, por ishin miq. Arshi Pipa ishte shumë pak fleksibël, nuk ishte i kollajtë, ai vështirë se e ndryshonte mendimin e tij rreth letërsisë shqipe.

Ne e kemi vlerësuar shumë miqësinë me të, gjithsesi.

20. Në një poezi të Martin Camajt të titulluar *Fragment*, tërheqin vëmendjen këto vargje: *Dita e nata janë ndá kaherë./Por të gjithë e dimë se në terr / Bie gjak e shí.*

Në *Shkushullim* ai shkruan: *Kush iu kujtue territ / që bije në luginë mbas fikjes së yjve (...)* koha e mungët / mes dritave / i hyn në palcë gurit / dhe ashtit njerëzor. / Terrin mes dy dritave / s'e duron ylli që shkoqet, / as njeriu.

Te *Pleqnime me vete*, *Tha i urti: çdonjeni asht një ngjyrë / e na hije në të / prej bardh deri në zi.* Vetë Martini pohon: *fund e maje vepra ime ka Provaninë e Perendisë mbrendë. Ndërsa: Palimpsest, shkruie në dy vjetet e fundit, sos me tematikë mistike. M'anë tjetër, fuqia mistike e gjarpnit, e buellit, e formulave të mengjisë, deri dhe mistika e lules...*

Pyetja jonë tani lidhet tani pikërisht me këtë përmasë të mistikes në veprën camajane të lidhur sidomos me zanafillën. Na tërheq ideja e tingullit, koncepti metafizik për të dhe tek e mbrama, e me më peshë se gjithçka, vetë akti i krijimit, sendërtuar në cilësinë më të lartë të tingullit, në esencialen e tij të përnaltësuar.

A ishte Camaj udhëtari që zgjoi *tingujt e ujit prej gjumit*?

Erika Camaj: Poezia, ajo nuk ishte punë e lehtë për Martinin. Çdo gjë ishte një tingull për të.

Ai punonte me çdo zanore dhe bashkëtingëllore. Ishte gjithmonë i kujdesshëm që edhe ta përpunonte poezinë por edhe që ajo të ishte e rrjedhshme, të ndihej si një tingull virgjin. Tingulli pra, ishte shumë i rëndësishëm dhe kjo dallohet kur lexohet poezia e tij.

21. Camaj ka nënshtruar në trajtat e tij poetike edhe vargjet më të pabindura. Bota e Camajt është sa shqiptare për nga natyra, shenjat, mitet po aq dhe kozmopolite e originale për nga konstruktet e saj. Çfarë lexonte ai nga letërsia gjermane-një matricë jo e njohur e formimit të tij,- tekta janë të kudondodhura ndikimet prej letrave

shqipe e poezisë italiane hermetike në teksturën që na tërheq pafundësisht.

Deri në ç'masë mund të na tregoni: a mund të keni diktuar ndonjë pikëtakim? Përpos veprave të hermetizmit, çfarë nga letërsia e përbotshme donte më shumë? Cilët autorë?

Erika Camaj: Unë nuk jam studiuese e letërsisë, jam mjeke, por mund të them që Camaj ka lexuar shumë nga shkrimtarët dhe poetët gjermanë. Në fakt, më së shumti, ai ka lexuar letërsi italiane dhe franceze.

Letërsia gjermane erdhi më vonë kur ai mësoi mirë gjermanisht.

Po përmend një: Ai e lexonte intensivisht Bertolt Brecht-in. Thomas Mann-in, nga ana tjetër, nuk është se Camaj e vlerësonte shumë. Në fakt, isha unë ajo që e solla Camajn te Thomas Mann.

22. Atëherë, ka ndonjë ndikim prej formimit tuaj në fushë të mjekësisë në artin e tij letrar? Përpos frymëzimit, dashurisë dhe një mirëkuptimi bukur të ekuilibruar, si e keni ndihmuar ju si mjeke në artin letrar?

Erika Camaj: Te *Budenbrokët* e Mann-it jepet përshkrimi i një infarkti zemre. Edhe në romanin *Rrathë* të Camajt jepet përshkrimi i një infarkti zemre. Si mjeke, e ndihmova për këtë përshkrim. Ishte shumë interesante për mua asokohe të krahasoja se si e përshkruan infarktën e zemrës një gjerman dhe një shqiptar. Unë nuk e njoh shkëlqyeshëm letërsinë gjermane por, mesa di, përshkrimi i një infarkti zemre gjendet vetëm te Mann-i, dhe te letërsia shqipe vetëm te Camaj.

23. Ju pëlqenit më shumë poezinë apo prozën e tij? Cilat botime të tij i keni më për zemër?

Erika Camaj: Mua më kanë pëlqyer gjithmonë më shumë novelat e Camajt. Novela ime e preferuar ka qenë dhe mbetet *Rrugë në mars*, sepse historia e dashurisë është përshkruar në mënyrë të mahnitshme në këtë novelë.

23. Njerëzit e tij nuk i pa më kurrë?

Erika Camaj: Ishte fillimi i viteve '60 dhe Shqipëria ishte krejt e izoluar nga bota, dhe Martin Camaj kujdesej shumë që të mos kishte kontakt të drejtpërdrejtë me shqiptarët. Gjithmonë thoshte që nëse i kontaktonte ai do t'u bënte keq këtyre njerëzve sepse emri dhe figura e tij ishin tabu në Shqipëri.

Megjithatë, gjithmonë interesohet për familjen e tij të shqiptarët e Kosovës. Kishte njerëz në Kosovë që arrinin të gjenin informacione dhe e

siguronin që familja e tij ende jeton. Më shumë se kaq ishte e pamundur të merrte vesh.

Gjithsesi, në vitet kur komunizmi po rrëgohej e telefoni vëllai i tij Gjergji njëherë. E mbaj edhe sot mend zërin sepse zëri i tij ishte shumë i zbehtë për një burrë. Dëshironte të vinte të vizitonte Martinin, por Martini ishte me kancer dhe në periudhën e fundit të jetës së tij.

I tha të vëllait: *Jo, mos eja, të lutem, të paktën jo në këtë moment.* Nuk dëshironte që njerëzit ta shihnin në atë gjendje. Më pas ai vdiq.

Pra, familjen e tij ai nuk e pa më kurrë dhe kjo është tej mase tragjike dhe e trishtueshme. Ai nuk e pa asnjëherë më atdheun e tij.

Për Martinin, si një malësor, atdheu ishte një përkatësi e përhershme brenda tij.

24. Si ishin ditët e fundit të Martin Camajt?

Erika Camaj: Në ditët e fundit Martini qëndroi në spital. Dëshira e tij ishte të qëndronte në shtëpi mirëpo mua më nevojiteshin dy infermierë të tjerë sepse ai nuk mund të lëvizte më. Vendosa dhe një shtrat tjetër në spital dhe qëndroja ditë e natë pranë tij.

Ndërroi jetë në krahët e mi.

25. Ai prehet në një vend të paqtë, këtu në Lenggries. Do të qëndrojë në këtë vend të qetë, i patrazuar nga erërat ende të ashpra të mjediseve shqiptare? Apo do të vijë një ditë të prehet në Alpet tona?

Erika Camaj: Jam kujdesur ndërkohë, që të porosis një varr në Shkodër. Është i madh, në fakt, për katër persona. Gjergji është varrosur ndërkohë, Zefi vëllai tjetër është varrosur lart në male. E kam vizituar dhe këtë varr, të shoqëruar me gurë dhe me cigare. Mendoj që Zefi nuk ka pirë ndonjëherë cigare, por kjo është tradita.

26. Martini, më i vetmuari poet i botës shqiptare në shekullin e njëzetë. Camaj e kish njohur vetminë si fytyrën e tij në pasqyrë, pos saj dhe valenca të dhimbshme: mospërfilljen, ashtu si mallin dhe harresën. Keni përfytyruar ndonjëherë: si do të ishte jeta e tij po të mos ishte arratisur nga Shqipëria?

Erika Camaj: Nëse Martini do të qëndronte në Shqipëri nuk do të kishte jetuar gjatë. Mendoj se do ta degdisnin në ndonjë kamp përqendrimi, do të ishte pushkatuar. Këtë ai e ka thënë dhe vetë.

27. Pas largimit të Martinit nga jeta, ju erdhët në atdheun e tij, por më parë nuk keni dashur ta vizitonit Shqipërinë.

Erika Camaj: Kur regjimi i Hoxhës ra, unë isha e vendosur: nuk do ta vizitoj kurrë Shqipërinë, për arsye se ata njerëz e kanë trajtuar bashkëshortin tim shumë keq, e kanë bërë të vuajë. Këtë ia kam thënë vetë z. Sali Berisha, gjatë vizitës që më bëri asokohe si President i Republikës së Shqipërisë.

Më mbropa nuk e mbajta premtimin tim. E vizitova Shqipërinë dhe do ta vizitoj çdo vit. Por ai që më bindi të shkoja ishte përsëri Gjergji, vëllai i Martinit. Më telefonoi një ditë dhe i vendosur më tha: *Tani a do të vish në Shqipëri apo jo, sepse nëse nuk vjen ti, atëherë do të vij unë.*

Kjo vendosmëri e tij më goditi, në fakt. Thashë më vete: *çfarë do të bëjë ai këtu? Unë nuk di mirë shqip, ai nuk di gjermanisht.* E në fund vendosa të shkoj unë.

Shkova dhe ai po më priste në aeroport (o Zot i madh!). Në fakt prisja një burrë trupmadh si Martini, por përpara më doli një burrë shtatpakët, me siguri, mendova, i ushqyer jomjaftueshëm. Qartë, kishte kaluar 30 vite në burg. Në fakt ishte krejt i paushqyer.

Mbaj mend që më solli disa këpucë të forta dhe më tha: *vish këto sepse nuk mundesh më ecë atje ku do të shkojmë me këto këpucë që ti i ke veshë.*

28. Diçka që nuk ishte siç e përfytyronit në këtë përvojë, që, në një mënyrë mund t'ju ketë çmagjepsur -çfarë ishte? E diçka që ju gëzoi më shumë sa e prisnit?

Erika Camaj: Unë e dija që në liqenin e Shkodrës kishte lloje të veçanta peshqish. Kur isha atje dëshiroja ta provoja, por më duhet të them që mbeta pak e zhgënjyer sepse peshku nuk ishte dhe aq i vecantë.

Ndërsa, takimet që pata në Shkodër ishin vërtet të mrekullueshme, duke filluar që nga kryetari i bashkisë, rektori i universitetit. Ishin një tufë me burra që më pritën në hyrje të Shkodrës.

Këtë nuk e harroj gjithë jetën time. Nuk isha kurrë vetëm, gjithmonë e shoqëruar.

29. Gjatë bashkëjetesës suaj bashkëjetuan dy kultura; a kishte një pengesë (kulturologjike), të cilën nuk mund ta tejkalonit lehtë, diçka, që, si të thuash, mund t'ju çonte drejt mosmarrëveshjeve? Thënë në një mënyrë tjetër: çfarë do të donit të kishte qenë ndryshe...

Erika Camaj: Në fillim pata probleme. Koliqi dhe Schirò-i e këshillonin Martinin që gruaja e një profesori nuk duhet të punojë. Kjo ishte e pakonceptueshme për mua. Unë kisha investuar shumë në profesionin tim. Arrita nivele të larta sepse kreu provimet shtetërore amerikane për mjekësi.

Kur ai më kërkoi të mos punoja i thashë, Jo.
Kjo ishte me të vërtetë një periudhë krize në marrëdhënien tonë.
Ajo çka më shpëtoi ishte shtëpia. Ne kishim për të paguar shumë kredi për shtëpinë që ndërtoam.
Kemi jetuar shumë këndshëm dhe plot me begati, falë punëve të të dyve.
Martinit dhe shokëve të tij ua bëra të qartë që unë nuk jam një grua që e marr titullin nga burri im dhe që jam e lirë dhe e pavarur.
Këtë liri dhe pavarësi ma garantonte shkollimi im.

30. Patët një rrjedhë të bukur e të mirë jete...

Erika Camaj: Ne kishim marrëdhënie shumë të mira me njëri-tjetrin. Mbi të gjitha, ishim të dy të lirë në mënyrën se si mendonim. Si intelektualë, ne kishim të dy jetët tona dhe i jetonim ato.

Ne ishim një çift shumë normal, kishim gabimet tona, nxitimet tona. Por si malësor, ai kishte një karakter shumë pozitiv.

31. Zonja Erika Camaj, kur lexojme *Verë e lumtun*, nuk mund të mendojmë vetëm për një stinë. Te Letër Gjon Sinishtës 1991, Martini shkruan: *I dashtuni Gjon, ... t'uroj Pashkët me familje edhe në emën të Erikës që sot punon për nja disa orë.*

Ne letrat dërguar Anton Nikë Berishës ai përshëndet në emrin tuaj: *Të fala dhe prej Erikës - dhe kështu kurdoherë, derisa ai ju dhuron krejt vëllimin më të bukur: *Njeriu me vete e më tjerë me fjalët në krye: *Kushtue sime shoqe, Erikës. Çfarë mendoni kur i shikoni?***

Erika Camaj: Unë mendoj që letërsinë më të bukur Martini e ka krijuar gjatë qëndrimit me mua. Periudha më prodhimtare e Camajt ishte ajo e qëndrimit në Gjermani.

Po njësoj edhe për mua.

32. Zonja Camaj, dhe së fundmi dhe esencialisht si do ta përshkruanit (me dy-tri fjalë) Njeriun Camaj? Poetin? Profesorin?

Erika Camaj: Si po më thoni? Ta përshkruaj Camajn me tri fjalë? Të përshkruaj një personalitet me tri fjalë është sigurisht, shumë e vështirë. Njeriu është në vetvete shumë i komplikuar dhe përbën një sekret që nuk mund të përshkruhet në tri fjalë. Por unë si gruaja e tij kam qenë pjesëmarrëse në jetën e tij si shkrimtar, dhe më kanë dhënë gjithmonë kënaqësi diskutimet me të. E kam financuar vetë një pjesë të punës së tij. Edhe në ditët e sotme, që jam e vetme kam kujtime shumë të bukura.

33. Profesori Martin Camaj për më shumë se njëzet vjet ligjëroi shqipen në Universitetin e Munihut, ku mësoi dhe formoi dhjetëra

albanologë të huaj, ndër të cilët edhe Hans-Joachim Lanksch-in, nga miqtë e tij më të afërt. Ish studentet e tij, sot personalitete të botës perëndimore akademike, Elvira Glasser, Walter Breu dhe të tjerë shfaqin adhurim ndaj tij edhe sot. Në shtëpinë tuaj çdo vit bëhet *Festa e verës* në nder të Martin Camajt, ku patëm fatin të festojmë kaq hijshëm. Mendojmë se ai është me ne...

Erika Camaj: Festa verore që unë organizoj nuk është në nder të Martin Camajt, por në nder të studentëve të Albanologjisë.

Gjithmonë në fund të vitit Camaj i mblidhte studentët e vet këtu në shtëpi, si një lloj shpërblimi për punën e tyre gjatë gjithë vitit.

Të njëjtën gjë bëj dhe unë. Unë e vlerësoj shumë edhe kur vijnë studentë që nuk studiojnë Albanologji dhe nuk janë shqiptarë. Mendoj se shkëmbimi mund të zgjojë interes për Albanologjinë tek ata.

Kjo festë do të organizohet për studentët e Albanologjisë gjersa të më sosë fryma.

Lenggries, Alpet e Bavarisë, korrik 2022

* * *

Nga dritarja e dhomës së punës së Martinit duket lëndina e blertë, aq tërësisht e blertë; prej aty dhe nisin pyjet me një pamje idilike, pafundësisht serene. Pyesim veten duke buzëqeshur “mos jemi ngjitur vallë, në Parriz?”

Jemi në studion e Martin Camajt tani. Sytë tanë bien mbi tryezën e punës (dëshirë, po dhe një lloj ngurrimi për ta prekur); aty është ndenjësja e rëndë, kompjuteri, stilolapsat. Aty janë gjithë letrat dhe librat. Në raftë: enciklopedi, fjalorë të ndryshëm, libra të mëdhenj e të vegjël, të vjetër e më pak të vjetër; në gjuhë të ndryshme. Pjesa dërrmuese e librave kanë lidhje me albanologjinë. Dallojmë numra të revistës Nëntori, Studime Filologjike, vepra të Ismail Kadaresë dhe Jakov Xoxës, dhe të të tjerëve autorëve shqiptarë. E dimë prej shkrimeve të tij dhe prej hulumtimeve tona në arkivin shtetëror të Munihut sesi e ndiqte ai zhvillimin e letërsisë shqipe në atdheun e largët.

Dhe ja, vitrina e qeltë e breshkave, si një shtëpizë, si një ekspozitë a muzei i vogëlth. Guaska të vërteta dhe të krijuara të breshkave të llojeve nga më të ndryshmet, të madhësive e ngjyrave të larmishme, - krijesa e papërsosur që e frymëzoi të shkruante veprën me emrin e trandafilit.

Në dhomën në katin e sipërm, nën çati, ruhen të kyçura kopjet e dorëshkrimeve, kopje të të gjithë librave të tij, të letrave, fotografi që shënjojnë çaste kulmore në jetë, me miq të çmuar, kolegë, shqiptarë të diasporës dhe shoqen e jetës së tij, Erika Camaj.

Ja, aty, nën qiellzanë: Nji fyell ndër male (1953) dhe botimet e Munihut në

shqip, të cilat zonja Camaj me bujari na i dhuron, mandej, botime në gjuhë të huaja: anglisht, gjermanisht, italisht, që përmbyllen me botimet e fundit nga Camaj-Pipa në Shkodër.

Të gjitha dyert janë sipas stilit arbëresh, me doreza të përdredhura si gjarpri.

Ndofta njëzet e ca piktura të piktorit Gjelosh Gjokaj të varura në mure përhapin shpirtësinë shqiptare e na kujtojnë se çdo krijim i njëmendtë zë fill nga tronditjet e e mëdha shpirtërore. E gjithë shtëpia mban një komunikim të harmonishëm me këto piktura.

Bota e Martinit është këtu, vetëm Martini nuk është.

* * *

Zonja Erika Camaj na ka treguar dhe atë që na le përshtypjen më të thellë, Odën shqiptare. Gjithandej gur: dysHEME e gurtë, oxhak i madh me trungje, dhe mure të gurtë të bardhë, një jelek, një xhamadan varur në mur. Në krye të odës një lahutë e një sharkí. Tryeza e madhe e drurit me ndenjese të rënda e të mëdha; tepsi, gjyma, pjata dhe orendi bakri; punime zbukurimi, velenxë, tepih nga Kosova, qilima dhe punë të tjera në lesh me motive karakteristike shqiptare, ngjyrat kuqezi dhe, natyrshëm, shqiponja dykrenare.

Ngjyrat vagullohen ndonjë herë si në avull, njëlloj si në vendlindjen e tij të largët, Temalin e Dukagjinit. Këtu është pikënisja dhe përfundimi. Këtu jemi mu në zemër të botës shqiptare.

Qetësia e Alpeve Bavareze, ka thirrur qetësinë tjetër, atë të humbur, ajo ka kërkuar një kohë të kaluar. Kronotopia camajane kthehet kësajoh në elementin strukturor të rrugës jetësore dhe të truallit të veprës letrare, dhe lidhet me qëllimin e Njeriut Camaj për të projektuar qenien dhe qenësinë shqiptare në hapësirën dhe në kohën e pafundme.

Vetëm dyzetë e pesë minuta dhe po aq kilometra nga Munihu i zëshëm dhe modern, Camaj e vjetëroi kohën dhe solli këtu një pjesë të Dukagjinit, Kosovës, jetës arbëreshe.

I Urti Martin Camaj, në zemër ka bartur krejt botën shqiptare dhe mbi shpinë konsekuencën e humbjes së udhës së drejtë; ka ndërtuar dhe jetësuar këtu në Alpe të Bavarisë mbamendjen historike e atë të qenësisë shqiptare.

Emri dhe vepra e tij frymon, shpirtësia e tij ndihet kudo në shtëpi, Padyshim, që

“Dashunija rrin këtu derisa hana të jesë”. (M. Camaj)

Biseduan Viola Isufaj dhe Ledio Hala

